



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
SEKTORI I PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot.

Patos, më 21/04/2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Blerje bazë materiale për ndriçimin rrugor

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Materiale elektrike 31681410-0, Shtylla për ndriçim rrugor 34928510-6, Ndryes rrugorë 34993000-4

VLERA E FONDIT LIMIT: 10,491,550 (dhjetë milion e katërqind e nëntëdhjetë e një mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga të ardhurat lokale për vitin 2026, për objektin: **“Blerje bazë materiale për ndriçim rrugor”**.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Patos** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se fondi limit i procedurës objekt prokurimi përkatesisht **10,491,550** (dhjetë milion e katërqind e nëntëdhjetë e një mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2.2 Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2025.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-se).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi fitues përpara dhënies së kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2025 prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në

përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate (*apo shumatores së fondit limit të loteve, nëse kontrata është e ndarë në lote dhe ofertohet për më shumë se një lot*).

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4 (*ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b*), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se ... % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

10,491,550 x 40% = 4,196,620 Lekë.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të vetdeklarohet (me anë të paraqitjes së një deklarate) se ofron garanci 2 vjeçare për ndriçuesat LED dhe 1 vit për bateritë e ndriçuesit LED me Panel diellor.

ARGUMENTIM: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 8 të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky

vetdeklarim kërkohet per ti vertetuar dhe garantuar AK-së produkte funksionale dhe realizimin me sukses të kontratës përsa i përket dorëzimit të mallrave objekt prokurimi.

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë në pronësi ose me qera, mjetet e mëposhtme:

- Mjet vetshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 5 ton copë 1
- Kamion me vinç copë 1

Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose qera (me kontratë noteriale), duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtem:

- lejen e qarkullimit.
- certifikatat e pronësisë, në rastin kur është aplikuar.
- siguracionin e mjetit,
- kolaudimin,
- certifikatë transporti
- fotografi të mjetit te paraqitura. (të cilat duhet të jenë në emër të shoqërisë ose në emër të qeradhënësit).

Për mjetet dhe pajisjet te cilat nuk kanë leje qarkullimi, Ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratë noteriale të blerjes,
 - fatura tatimore të blerjes ose dokumenta zhdoganimit të mjetit.
- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit, , leje qarkullimi, plus certifikatën e kontrollit teknik , siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij, leje qarkullimi, plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit,(të vlefshme) , të shoqëruar me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit noteriale,, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.*
- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pikës 5/ç nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, mjetet dhe pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Këto mjete janë kërkuar nisur nga sasia e konsidueshme e mallrave objekt prokurimi, vendodhjet e ndryshme te objekteve ku do të vendosen materialet.

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të paraqesi autorizim prodhuesi ose autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/distributorit si: telefon, fax, email, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Nr	Emërtimi I materialeve	Njësia	Sasia
5	Krah tek	copë	1
6	Shtyllë dekorative me dy krah me llampa led 4m	copë	1
8	Shtyllë dekorative e galvanizuar për lulishteme ndriçues katror led	copë	1
9	Ndriçues LED 30 W	copë	1
17	Ndriçues LED me panel diellor 240 W	copë	1
18	Ndriçues LED me panel diellor 400 W	copë	1
30	Ndriçues led katror 50W+dvr ip 68	copë	1
31	Koke metalike dekorative për ndriçues rrethor	copë	1

Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit si dhe skedën teknike për listën e mësipërme, në të cilët të tregohen dhe specifikohen qartë materialet që do të ofrohen, në rastin kur janë në gjuhë të huaj ato duhet të përkthehen dhe noterizohen në gjuhën shqipe.

ARGUMENTIM: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 5/a dhe pika 8, të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

2.3.5. Operatorët ekonomik pjesmarrës në procedurën e prokurimit duhet të dorëzojnë në ambientet e magazinës pranë Bashkisë Patos brenda datës 07/05/2026 ora 09:00, (para hapjes së fazës së vlerësimit nga KVO përkatëse) mostrat për zërat si më poshtë:

Nr	Emërtimi i materialeve	Njësia	Sasia
5	Krah tek	copë	1
6	Shtyllë dekorative me dy krah me llampa led 4m	copë	1
8	Shtyllë dekorative e galvanizuar për lulishteme ndriçues katror led	copë	1
9	Ndriçues LED 30 W	copë	1
17	Ndriçues LED me panel diellor 240 W	copë	1
18	Ndriçues LED me panel diellor 400 W	copë	1
30	Ndriçues led katror 50W+dvr ip 68	copë	1
31	Koke metalike dekorative për ndriçues rrethor	copë	1

Ky kriter i shërben Autoritetit Kontraktor për rëndësinë e mallrave dhe përshtatshmerinë që duhet të kenë në objektet ekzistuese ndaj është e nevojshme sjellja e mostrave.

Shënim: Ky kriter përbën kusht skualifikimi në rast se mostrat e dorëzuara nuk janë sipas specifikimeve teknike të kërkuara. Mosparaqitja e mostrave përbën kusht për skualifikim. Mostrat e dorëzuara do të kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas

nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostra i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në piken 6 gërma a, të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: 6. *Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial 39 tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.*

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP . Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Skicimet, parametrat teknik etj:

1. Ndrriçues LED 50 W

Fuqi Nominale: 50W

Tensioni nominal: 85-265 V

Frekuenca nominale: 50/60Hz

Lloji i LED: SMD
Drajveri ose ushqyesi: Jo i izoluar
Faktori i fuqisë (PF): $PF > 0.9$
SPD (Mbrojtja nga mbitensionet): 3000V
Efikasiteti i ndritshëm($\pm 5\%$): $\geq 118 \text{ LM/W}$
Fluksi i ndricimit ($\pm 5\%$): $\geq 6000 \text{ LM}$
Kendi i ndricimit: $\geq 120^\circ$
Devijimi standard i përputhjes së ngjyrave: $< 5 \text{ SDCM}$
CRI (indeksi i ngjyres RA): RA70
CCT (Temperatura e ndricimit): 3000K/4500K

Specifikimet mekanike

Materali i trupit: Die- cast Alumin
Materiali i lenteve: PC
Temperatura e ambientit: -40°C - $+50^\circ\text{C}$
Numri i Cikleve te shkycjes: $\geq 100,000$
Jetgjatesia L70 në 25°C : $\geq 20,000 \text{ H}$
Zbehja: Jo zbehje
Lloji i lidhjes: 3-polar
Standardet
Klasa e mbrojtjes: Klasa I
Lloji i mbrojtjes: Ip66
Garancia: 1 vit

2. Ndricues LED 100 W

Fuqi Nominale: 100W
Tensioni nominal: 85-265 V
Frekuenca nominale: 50/60Hz
Lloji i LED: SMD
Drajveri ose ushqyesi: Jo i izoluar
Faktori i fuqise(PF): $PF > 0.9$
SPD (Mbrojtja nga mbitensionet): 3000V
Efikasiteti i ndritshëm($\pm 5\%$): $\geq 118 \text{ LM/W}$
Fluksi i ndricimit ($\pm 5\%$): $\geq 11800 \text{ LM}$
Kendi i ndricimit: $\geq 120^\circ$
Devijimi standard i përputhjes së ngjyrave: $< 5 \text{ SDCM}$
CRI (indeksi i ngjyres RA): RA70
CCT (Temperatura e ndricimit): 3000K/4500K

Specifikimet mekanike

Materali i trupit: Die- cast Alumin
Materiali i lenteve: PC

Temperatura e ambientit: - 40°C-+50°C

Numri i Cikleve te shkycjes: $\geq 100,000$

Jetgjatesia L70 në 25°C: $\geq 20,000\text{H}$

Zbehja: Jo zbehje

Lloji i lidhjes: 3-polar

Standardet

Klasa e mbrojtjes: Klasa I

Lloji I mbrojtjes: Ip66

Garancia: 1 vit

3. Ndrichues LED me Panel diellor $\geq 240\text{ W}$

Fuqia: $\geq 240\text{ W}$

Paneli diellor: $\geq 3.6\text{ Ah}$

Dimensionet e panelit diellor(mm): $\geq 390\text{x}\geq 210$

Koha e karikimit: 5-6 H

Koha e ndriçimit: 12-15 H

Sensori: Sensor levizje dhe sensor I dritës

Koha e ndjeshmerise: 5-10 m

Mënyra e funksionimit: Modaliteti i sensorit te levizjes dhe mënyra e kontrollit të dritës

Këndi i rrezes: $\geq 120^\circ$

CCT(temperature e ngjyres): 6500K

Materiali i trupit: ABS, xhami i temperuar

Ngjyra e kases: nuk ka përcaktim

Gama e temperaturës së operimit: -40~+50°C

Numri i cikleve të ndërrimit: $\geq 100,000$

Jetëgjatësia L70 në 25°C: $\geq 100,000\text{ H}$

Standardet

Klasa e mbrojtjes: Klasa I

Vlerësimi IP: IP 68

Garancia: 1 vit

4. Ndrichues LED me panel diellor 400 W

Fuqia: $\geq 400\text{ W}$

Paneli diellor: $\geq 3.6\text{ Ah}$

Dimensionet e panelit diellor(mm): $\geq 610\text{x}\geq 230$

Koha e karikimit: 5-6 H

Koha e ndriçimit: 12-15 H

Sensori: Sensor levizje dhe sensor i dritës

Koha e ndjeshmerise: 5-10 m

Mënyra e funksionimit: Modaliteti i sensorit te levizjes dhe mënyra e kontrollit të dritës

Këndi i rrezes: $\geq 120^\circ$

CCT(temperature e ngjyres): 6500K
Materiali i trupit: ABS, xhami i temperuar
Ngjyra e kases: nuk ka përcaktim
Gama e temperaturës së operimit: -40~+50°C
Numri i cikleve të ndërrimit: $\geq 100,000$
Jetëgjatësia L70 në 25°C: $\geq 100,000$ H
Standardet
Klasa e mbrojtjes: Klasa I
Vlerësimi IP: IP 68
Garancia: 1 vit

5. Ndriçues led katror 50W+dvr ip 68

Specifikimet teknike – Ndriçues LED katror 50W + Driver IP68

Karakteristikat bazë

- **Tipi:** Ndriçues LED (Floodlight / Projektor)
- **Forma:** Katror
- **Fuqia:** 50 W
- **Driver:** i integruar (DVR – driver elektronik për stabilizim tensioni)
- **Teknologjia LED:** SMD ose COB

Parametrat elektrikë

- Tensioni i punës:
 - 220 – 240 V AC
- Frekuenca: 50/60 Hz
- Faktori i fuqisë (PF): ≥ 0.9
- Efikasiteti ndriçues:
 - 100 – 130 lm/W
- Fluksi i ndriçimit:
 - rreth 5000 – 6500 lumen

Ngjyra 4000K

Mbrojtja dhe qëndrueshmëria

- Shkalla e mbrojtjes: IP68
 - 100% rezistent ndaj pluhurit
 - rezistent ndaj zhytjes në ujë (>1 m)
- Rezistencë ndaj kushteve atmosferike: shi, borë, lagështi, kripë
- Rezistencë ndaj goditjeve: IK07 – IK08

Materiallet

- Trupi: Alumin i derdhur (die-cast) për disipim të nxehtësisë
- Xhami/Lentja: Polikarbonat ose xham i temperuar
- Mbulesa: anti-korrozion

Kushtet e punës

- Temperatura e funksionimit:
 - nga -30°C deri +50°C
- Lagështia: deri në 95%

Jetëgjatësia

- Jetëgjatësia:
 - deri në 50,000 orë pune
- Ciklet ON/OFF: >20,000

6. Shtyllë konike 7.8 m

Shtyllat që do të blihen duhet të jenë sipas karakteristikave që jepen si më poshtë:

Lartësia e shtyllës	7.8 m
Spesori	3 mm
Shkalla e mbrojtjes	Ip66
Forma e shtyllës	konike
Materiali	Çelik i galvanizuar

7. Shtyllë konike 5.8 m

Shtyllat që do të blihen duhet të jenë sipas karakteristikave që jepen si më poshtë:


Lartësia e shtyllës	5.8 m
Spesori	3 mm
Shkalla e mbrojtjes	Ip66
Forma e shtyllës	konike
Materiali	Çelik i galvanizuar

8. Shtylla dekorative me dy krah me llapma led 4m

Lartësia e shtyllës	4.0 m
Lloji i shtyllës	metalike e galvanizuar
Mbrojtja	IP 68

Shtylla do të ndahet në 3 sesione duke filluar nga poshtë lartë, gjatësia e sesionit të parë do të jetë 65cm e dekoruar me elemente antikë dhe do të jetë, alumin, sesioni i dytë do të jetë 135cm tub i galvanizuar $\Phi 90$ ku në përfundim të tij do të ketë një element dekorativ rrethor, sesioni i tretë do të jetë 200cm tub i galvanizuar me përmasë $\Phi 76$ me kapele dekorative me majë në forme heshte. Sesioni i tretë duhet të jetë 200cm sebashku me kapelen. Shtylla duhet të ketë ndricues nga të dy anët në model antikë me dhoma për vendosjen e llambave led.

Përmasat e dhomës së ndricuesve duhe të jetë afersisht 53cm i lartë, 36cm i gjerë të pjesën e sipërme dhe 17cm i gjerë në pjesën e poshtëme për të kryer përhapjen e dritës në mënyrë të përshtatëshme dhe të njëtrajtëshme komibuar me të gjitha shtyllat e vendosua në seri. Për këtë zë në preventive operatori ose operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi duhet të paraqesin mostër, për shkakë të rëndësisë që ka ky zë në pamjen vizuale dhe ndricimin e qytetit. Ilustrim i përafërt i shtyllës dekorative:



9. Shtyllë dekorative e galvanizuar për lulishteme ndriçues katror led

Koka e shtyllës duhet të jetë material alumini i jodizuar

Tubi i shtullës duhet të jetë me përmasë $\Phi 89$ i galvanizuar.

Të dy elementët duhet të jenë të lyer me bojë elektrostatische në furrë.

Ngjyra RAL 7016

Ndriçuesi Led 50W

4000K (Bardhë Natyrale)

Mbrojtja IP68



10. Krahë tek D60 1000 x 1000

Materiali: Çelik i galvanizuar
Përmasat: D60 1000 x 1000
Montimi: Në shtyllë cilindrike ose konike.

11. Lampa Led 60w

Jetëgjatësia: 15000 h
Fuqia: 60 W
Ndriçimi: 4000 K
Lloji i ndriçimit: E14
Marka: Philips

12. Kapak Shtylle

Kasetat metalike duhet të jenë hermetike e shoqëruar me guarnicion.
Përmasat: 45x 186 (ose të përafërta)

13. Pusete plastike 30x30x30

- Lartësia: 30cm
- Materiali: Polipropilen
- Përmasat: 30x30cm

14. Kabull PVC AL 4x16 mm²

Tensioni:	Kabullo me tension të ulët dhe të mesëm
Materiali izolues:	XLPE
Materiali i këllëfës:	PVC
Forma e materialit:	Tela e rrumbullakët
Materiali izolues	XLPE
Materiali përcjellës	Alumini

Aplikimi:

Si kabullo transmetimi energjie, për instalim fiks, mundësisht në kanal kabllor, brenda, jashtë, në ujë, në tokë, nëse nuk priten dëmtime mekanike gjatë funksionimit.

Struktura:

- përcjellës alumini, i ngurtë (SE) ose i përdredhur (RM / SM)
- Izolimi i bërthamës PVC
- Veshje mbushëse PVC (FM)
- Veshje e jashtme PVC, e zezë (rezistente ndaj UV)

Informacion:

temperatura e qarkut të shkurtër tek drejtuesi (maksimumi 5 s.)

$\leq 300 \text{ mm}^2 \rightarrow 160 \text{ }^\circ \text{C}$

$> 300 \text{ mm}^2 \rightarrow 140 \text{ }^\circ \text{C}$

Standardet:

DIN VDE 0276-603

HD 603 S1

DIN EN 60228 Klasat 1 dhe 2 (konstrukcioni i përcjellësit)

HD 308 S2 (shënjimi i telave)

Specifikimet:

Tensioni nominal U_0 / U [V] 600/1000 volt

Tensioni i provës [V] AC 4000

Temperatura e funksionimit u zhvendos [min / max] $-5 \text{ }^\circ \text{C} / + 70 \text{ }^\circ \text{C}$

Temperatura e funksionimit fikse [min / max] $-20 \text{ }^\circ \text{C} / + 70 \text{ }^\circ \text{C}$

Rrezja e përkuljes dizajn i thjeshtë x diametri i jashtëm 15

Rrezja e përkuljes me shumë versione x diametri i jashtëm 12

Standardi i vetive të djegies EN 60332-1-2

15. Kabëll FROR 3x2.5

Specifikimet teknike – Kabëll 3x2.5 mm²

- Numri i përcuesve: 3 (fazë + zero + tokë)
- Seksioni i përcuesit: 2.5 mm² për secilin përcues
- Materiali i përcuesit: Bakër (Cu), njëfilar ose shumëfilar
- Izolimi i përcuesve: PVC (polivinil klorid) ose XLPE
- Mbështjellësi i jashtëm: PVC (zakonisht ngjyrë gri ose e zezë)

Parametrat elektrikë

- Tensioni nominal:
 - 300/500 V (përdorim i brendshëm)
 - 450/750 V (varësisht nga tipi, p.sh. NYM, NYY)
- Rryma e lejuar (ampaciteti):
 - Rreth 16–25 A (në varësi të mënyrës së instalimit dhe temperaturës)
- Rezistenca e përcuesit:
 - $\sim 7.41 \text{ } \Omega/\text{km}$ (në 20°C për bakër)

Kushtet e punës

- Temperatura e funksionimit:
 - Nga $-15 \text{ }^\circ \text{C}$ deri në $+70 \text{ }^\circ \text{C}$ (PVC)
 - Deri në $+90 \text{ }^\circ \text{C}$ (XLPE)

- Temperatura gjatë instalimit:
 - Minimumi zakonisht 0°C

16. Kabëll FROR 2x2.5

Specifikimet teknike – Kabëll FROR 2x2.5 mm²

Karakteristikat bazë

- **Tipi i kabllit:** FROR (fleksibël, rezistent ndaj flakës – flame retardant)
- **Numri i përçuesve:** 2
- **Seksioni i përçuesit:** 2.5 mm² për secilin përçues
- **Materiali i përçuesit:** Bakër (Cu), shumëfilar (fleksibël)
- **Izolimi i përçuesve:** PVC (T12)
- **Mbështjellësi i jashtëm:** PVC (TM2), zakonisht ngjyrë gri

Parametrat elektrikë

- Tensioni nominal: 450/750 V
- Rryma e lejuar: rreth 16–20 A (varet nga instalimi)
- Temperatura max e qarkut të shkurtër: deri në 160°C (5 sek)

Kushtet e punës

- Temperatura e funksionimit:
 - +5°C deri +60°C në përçues
- Temperatura minimale (instalim fiks):
 - deri në -30°C
- Temperatura në përdorim të lirë:
 - rreth -5°C deri +60°C

17. Kabëll FROR 4x6

Specifikimet teknike – Kabëll FROR 4x6 mm²

Karakteristikat bazë

- **Tipi:** FROR (kabëll fleksibël, rezistent ndaj flakës)
- **Numri i përçuesve:** 4
- **Seksioni i përçuesit:** 6 mm² për secilin përçues
- **Materiali i përçuesit:** Bakër (Cu), shumëfilar (klasa 5 – fleksibël)
- **Struktura tipike:** 3 faza + 1 neutral (përdorim trefazor)

Parametrat elektrikë

- Tensioni nominal: 450/750 V
- Rryma e lejuar (ampaciteti):
 - rreth 32 – 50 A (në varësi të instalimit)
- Rezistenca e përçuesit: e ulët (bakër me përçueshmëri të lartë)

Materiallet

- Izolimi i përçuesve: PVC (TI2 / T12)
- Mbështjellësi i jashtëm: PVC (TM2), rezistent ndaj flakës
- Ngjyra: zakonisht gri

Karakteristika sigurie

- Flame retardant (FR) – nuk përhap flakën
- Emission i ulët i gazrave korrozivë
- Temperatura në qark të shkurtër: deri në 160°C (5 sek)

Kushtet e punës

- Temperatura e funksionimit:
 - +5°C deri +60°C në përçues
- Temperatura minimale:
 - deri në -30°C (instalim fiks)
- Temperatura max e përçuesit: deri në 90°C (në disa variante)

Parametra mekanikë

- Diametri i jashtëm:
 - rreth 12 – 13 mm
- Rrezja minimale e përkuljes:
 - 6× diametri (fiks)
 - 12× diametri (fleksibël)

18. Automat 10 A

Karakteristikat bazë

- Tipi: Automat magnetotermik (MCB)
- Rryma nominale: 10 A
- Numri i poleve:
 - 1P (fazë)
 - 1P+N (fazë + zero) – më i përdoruri në banesa
- Montimi: në shinë DIN 35 mm

Parametrat elektrikë

- Tensioni nominal:
 - 230 V (1 fazë)
 - deri në 400 V (3 faza)
- Frekuenca: 50/60 Hz
- Kapaciteti i ndërprerjes (breaking capacity):
 - zakonisht 4.5 kA – 6 kA
- Karakteristika e ndërprerjes (kurba):
 - B → për ndriçim
 - C → për përdorim të përgjithshëm (më e zakonshme)

Funksionimi mbrojtës

Automati 10A mbron instalimin nga:

- Mbingarkesa (overload) – aktivizohet termikisht
- Qarku i shkurtër (short circuit) – aktivizohet magnetikisht

Kushtet e punës

- Temperatura e funksionimit:
 - rreth -25°C deri $+50^{\circ}\text{C}$
- Temperatura e ruajtjes:
 - deri në -55°C deri $+55^{\circ}\text{C}$

Parametra mekanikë

- Gjerësia: ~18 mm (1 modul)
- Jetëgjatësia:
 - elektrike: ~10,000 cikle
 - mekanike: ~20,000 cikle

Kapacitet lidhjeje

- Përçues:
 - 1 – 16 mm² (rigid)
 - 1 – 10 mm² (fleksibël)

19. Adoptor E 40-E27

Specifikimet teknike – Adapter E40 / E27

Karakteristikat bazë

- **Tipi:** Adapter / konvertues baze llambe
- **Lidhja:**
 - **Input (hyrje):** E40 (bazë e madhe – “mogul”)
 - **Output (dalje):** E27 (bazë standarde)
- **Lloji i filetit:** Edison screw (vidhosje)
- **Funksioni:** Lejon përdorimin e llambave E27 në një portollambë E40

Parametrat elektrikë

- Tensioni nominal:
 - zakonisht 100 – 240 V AC
- Rryma maksimale:
 - rreth 2 A
- Fuqia maksimale (rekomanduar):
 - deri në 60–80 W (sidomos për llamba inkandeshente)

Materialet

- Trupi: Plastikë rezistente ndaj temperaturës (ABS ose PBT)
- Kontaktet: Bakër ose aliazh metalik për përçueshmëri të mirë

Kushtet e punës

- Temperatura e rezistencës:
 - deri në 80°C – 150°C (varësisht modelit)
- Rezistencë ndaj nxehtësisë: e përshtatshme për LED, CFL, halogjen

Parametra fizikë

- Diametri: ~40 – 50 mm

- Gjatësia: ~50 – 80 mm
- Pesha: ~20 – 45 g

20. Morsete Tokezimi

- Materiali: Zink
- Tipi: Sistem tokezimi

21. Klema 25mm²

- Materiali: Plastik/bronx
- Tipi: Mudulare

22. Kabëll 3x1.5

- Tensioni: FROR 450/750V
- Temperatura e punës: +5°C - +60° C on the conductor
- Materiali i izolimit: PVC T12/PVC TM2
- Materiali: Baker
- Tipi: Percjelles elektrike

213. Elektrodë tokëzimi

- Materiali: Bakër
- Gjatësia: 150 cm
- Tipi: Elektrodë tokëzimi
- Diametri: 16 mm

24. Nastro izolant

Material:	Tekstil
Tipi:	Izolant elektrik
Gjerësia:	19 mm
Gjatësia:	20 m

Shënim: Baza materiale do të dorëzohet nga operatori me dokumentacionin teknik përkatës sipas specifikimeve teknike të kërkuara.

Specifikimet teknike u hartuan nga **Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Patos** duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, në përputhje me përcaktimet e nenit 36 “Specifikimet teknike” të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, e nenit 40 pika 2, si edhe të Nenit 44 “Kerkesat e cilesise” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën **07/05/2025, ora 09:00**.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me **objekt “Blerje bazë materiale për ndriçimin rrugor”**.

Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin anëtar në NJP.

Bashkëlidhur këtij procesverbali:

Dokumentat e tenderit.

NJESIA E PROKURIMIT

Imela Halimi

Boreta Murati

Florian Kita